

Zgjedhjet e BE-së 2024

Qytetarët e Bashkimit Evropian i zgjedhin anëtarët e Parlamentit Evropian nëpërmjet zgjedhjeve çdo pesë vjet.

Nga Finlanda zgjedhen në Parlamentin Evropian 15 anëtarë, pra meppi.

Zgjedhjet e BE-së, pra zgjedhjet për Parlamentit Evropian, do të mbahen në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian në të njëjtën kohë.

Në Bashkimin Evropian janë 27 shtete anëtare.

Orari për zgjedhjet e BE-së 2024 në Finlandë është:

- Dita e zgjedhjeve është e dielë më 9.6.2024.
- Votimi paraprak në Finlandë është më 29.5.–4.6.2024.
- Votimi paraprak jashtë vendit është më 29.5.–1.6.2024.

Detyrat e Parlamentit Evropian

Parlamenti Evropian është
Institucion i Deputetëve të Bashkimit Evropian.

Parlamenti Evropian bën ligje
së bashku me Këshillin e Bashkimit Evropian.
Këshilli përfaqëson
shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

Parlamenti Evropian e miraton
buxhetin i Bashkimit Evropian
së bashku me Këshillin.

Parlamenti Evropian i mbikëqyr
komisionet dhe departamentet e Bashkimit Evropian.

Kush mund të votojë?

Ke mundësi për të votuar në zgjedhjet e BE-së, nëse

- i ke mbushur 18 vjeç jo më vonë se me datën **9.6.2024** dhe
- je shtetas/shtetase i/e Finlandës ose
- je shtetas/shtetase i një shteti anëtar të Bashkimit Evropian dhe je regjistruar në regjistrin për të drejtën e votës në Finlandë më së voni deri më 21.3.2024.

Kush mund të votohet?

Partitë dhe shoqatat e votuesve mund të emrojnë
kandidatët për zgjedhjet e BE-së.

Kandidati duhet të jetë shtetas i Finlandës me të drejtën për të votuar ose qytetar i një shteti anëtar të Bashkimit Evropian i cili është i regjistruar në regjistrin e Finlandës për të drejtën e votës.

Kandidatët për zgjedhjet e BE-së
janë të emruar në tërë shtetin,
kështu që mund të votohet për çdo kandidat.

Secili kandidat e ka numrin e tij të kandidatit.
Numrat e kandidatëve shfaqen
në shërbimin për rezultate të Ministrisë së Drejtësisë,
në qendrat e votimit dhe kabinat e votimit.

Informacione për kandidatët mund të merren, p.sh.
nga gazetat, televizioni dhe interneti.

Njoftimi për të drejtën e votës

Nëse ti ke të drejtë votimi,
për këtë një letër do të vijë në shtëpinë tënde.

Njoftimin për të drejtën e votës e merr vetëm në mënyrë elektronike,
nëse ke aktivizuar shërbimin Suomi.fi.
Suomi.fi është një shërbim i Agjencisë së Informacioneve Dixhitale dhe e Popullsisë.
Mund të lexohen më shumë informacione në faqën www.suomi.fi/viestit

Mundesh me zgjedhë, nese dëshiron me
votue në ditën e zgjedhjeve apo paraprakisht.
Nëse voton në ditën e zgjedhjeve,
shiko njoftimin e qendrës tënde të votimit për të drejtën e votës.

Nëse voton paraprakisht,
mundesh për të votuar kudo
në qendrat e votimit paraprak.
Njoftimi për të drejtën e votës shoqërohet me një listë
të vendeve për votimin paraprak në lagjen tuaj.

Merre letërnjoftimin me vete në qendrën e votimit. Nuk ke nevojë për të marrur me
vete njoftimin për të drejtën e votës në qendrën e votimit.

Votimi në shtëpi

Nëse aftësia jote për të lëvizur ose për të vepruar është e kufizuar,
ashtuqë për ty është shumë e vështirë për të
shkuar në qendrën e votimit për të votuar atje,
ti mundesh për të votuar paraprakisht në shtëpi.

Regjistrohu për votimin në shtëpi
në këshillin qendror zgjedhor të komunës suaj
më së voni deri në orën 16:00 të datës 28.5.2024.
Numri i telefonit gjendet në njoftimin për të drejtën e votimit.
Ti mundesh për të pyetur Këshillin Qendror të Zgjedhjeve për
më shumë informacione rreth votimit në shtëpi.

Kështu voton paraprakisht

Ti mund të votosh në zgjedhjet e BE-së paraprakisht
në çdo vend të votimit të parakohshëm.

Votimi paraprak në Finlandë është më 29.5.–4.6.2024.
Votimi paraprak jashtë vendit është më 29.5.–1.6.2024.

Merre me vete një dokument personal me fotografi në qendrën e votimit,
për shembull pasaportën, kartelën e identifikimit ose patentën e shoferit.

Vepro si më poshtë në qendrën e votimit paraprak:

- 1. Trego dokumentin tënd identifikues zyrtarit të zgjedhjeve.**
Zyrtarii do të japë ty një fletëvotimi.
- 2. Shko në kabinën e votimit.**
Shkruaje qartë në fletëvotim
numrin e kandidatit për të cilin voton.
Mos shkruaj asgjë tjetër në fletëvotim.
Numrat e kandidatëve mund të shihen në listën e kandidatëve,
që ndodhet në murin e kabinës së votimit.
- 3. Palose fletën e votimit në gjysmë në mënyrë,
që askush nuk mund ta shohë numrin.**
- 4. Kthehu te zyrtari i zgjedhjeve.**
Ai e vulos fletëvotimin
dhe të jep një zarf ngjyrë kafe.
- 5. Vendose fletëvotimin e vulosur në zarf
dhe mbylle zarfin me ngjytësin e tij.**

- 6. Zyrtaři i zgjedhjeve do të kërkjë për të nënshkruar formularin.**
Duke nënshkruar, ti e vërteton që e ke plotësuar vetë fletëvotimin, dhe kjo fletëvotimi është e vulosur dhe e ke futur në zarf.

- 7. Në fund, zyrtari vendos zarfin kafe dhe formularin në zarfin e verdhë.**
Zyrtari e mbyll me ngjitës zarfin e verdhë.
Dërgesa dorëzohet te Komisioni Qendror të Zgjedhjeve të komunës suaj.

Kështu voton në ditën e zgjedhjeve

Dita e zgjedhjeve është e dielë më 9.6.2024.

Në ditën e zgjedhjeve, qendrat e votimit janë të hapura prej orës 9 - 20.

Ti mundesh për të votuar vetëm në qendrën e votimit që shkruhet në njoftimin tënd për të drejtën e votës.

Merre me vete në qendrën e votimit një dokument identifikimi me fotografi, për shembull pasaportën, kartën e identitetit ose patentë shoferin.

Në qendrën e votimit vepro si më poshtë:

- 1. Trego dokumentin tënd të identifikimit zyrtarit e zgjedhjeve.**
Zyrtari do të kërkojë emrin tënd në listën zgjedhore dhe të jep një fletëvotimi.
- 2. Shko në kabinën e votimit.**
Shkruaje qartë në fletëvotim numrin e kandidatit për të cilin voton.
Mos shkruaj asgjë tjetër në fletëvotim.
Numrat e kandidatëve mund të shihen në listën e kandidatëve, që ndodhet në murin e kabines së votimit.
- 3. Palose fletën e votimit në gjysmë në mënyrë, që askush nuk mund ta shohë numrin.**
- 4. Kthehu te zyrtari i zgjedhjeve.**
Ai e vulos fletëvotimin.
- 5. Hidhe fletëvotimon tënd të vulosur në kutinë e votimit.**

Kush mund të ndihmojë?

Zyrtarët e zgjedhjeve do të këshillojnë dhe do të ndihmojnë në qendrën e votimit.

Në qendrën e votimit është edhe një ndihmës i zgjedhjeve. Këtij personi mund t'i kërkohet ndihmë në kabinën e votimit, nëse nuk mundesh për të shkruar vetë numrin e kandidatit në fletëvotim.

Ndihmës i zgjedhjeve mund të jetë gjithashtu një person, të cilin e ke zgjedhur vetë. Ai mund të jetë, për shembull, një familjarë ose një i afërm. Megjithatë, ndihmësi i zgjedhjeve nuk mundet të jetë kandidat ose i afërm i një kandidati.

Ndihmësi i zgjedhjeve nuk mund t'i tregoj askujt, për kë ke votuar.

Fshehtësia e zgjedhjeve

Secili vendos vetë, nëse deshiron të votoj dhe për kë voton.

Fshehtësia e zgjedhjeve do të thotë që nuk ke nevojë për t'i treguar askujt për kë voton.

Për shkak të fshehtësisë së zgjedhjeve, ti e plotëson fletëvotimin në kabinën e votimit.

**Voto në zgjedhjet e BE-së!
Kështu ndikon se kush e përfaqëson Finlandën
në Parlamentin Evropian për pesë vitet e ardhshme.**

Kjo broshurë shpjegon në gjuhë të kuartë
për votimin dhe zgjedhjet në BE-së në vitin 2024.

Për më shumë lexo në adresat:

vaalit.fi

elections.europa.eu/fi

selkokeskus.fi

Ti mundesh për të pyetur për zgjedhjet dhe votimin
edhe nga numri i shërbimit të Ministrisë së Drejtësisë
0800 9 4770.

Ti gjithashtu mundesh për të dërguar pyetjen tënde përmes mesazhit në WhatsApp
në numrin 050 438 8730